

THE KOSOVO BANKER

Dhjetor 2018 • Numër 14

Financimi i zhvillimit

Bankat për një zhvillim të
qëndrueshëm ekonomik të Kosovës

ROLI I BANKAVE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK

Ndikimi ekonomik që bankat kanë në industrinë dhe ekonominë në të cilat ato veprojnë është thelbësor dhe ekzistencial... **6**

BANKAT DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - LE T'I BËJMË ATO TË GATSHME PËR TË ARDHMEN!

Bankat si linjë e rëndësishme në ndërmjetësimin ekonomik... **13**

ROLI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT DHE ZHVILLIMIN E BUJQËSISË

Kosova gjatë viteve ka vazhduar të zhvillohet pozitivisht... **26**



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Publikim i Shoqatës së
Bankave të Kosovës



Kredi konsumuese

Plotësoni dëshirat dhe nevojat tuaja me kredi konsumuese me norma të ulëta interesi.



PËRMBAJTJA

#The Kosovo Banking Association

#Shoqata e Bankave

05 PARATHËNIE

— ILIR ALIU

SEKTORI FINANCIAR



06-12

Roli i Bankave në zhvillimin Ekonomik

— BERAT ISA

Zhvillimi i burimeve njerëzore në sektorin bankar — ANITA KOSUMI AJETI

KËNDI I EKSPERTËVE

13-25

Bankat dhe Zhvillimi Ekonomik - le t'i bëjmë ato të gatshme për të Ardhmen!
— JOHANNES ENGLÉS

Evolucioni i shpejtë i modelit të biznesit Bankar në vitet e paskrizës- ELVIS ZIU

Praktikat e pagesave në të gjithë Evropën: Pagesat e vonuara dhe mos pagesa e tyre vënë në rrezikë mbi jetesën e sipërmarrjes — KATERINA BOSEVSKA, EOS MAQEDONI, KOSOVË DHE MALI I ZI



26-29

Roli i institucioneve financiare për zhvillimin e sektorit privat dhe zhvillimin e bujqësisë — BERSANT DISHA

30-31 BANKIMI SIPAS NUMRAVE

32-33 KËNDI I EDUKIMIT FINANCIAR

Praktikanti nga Deutsche Bank viziton Shoqatën e Bankave të Kosovës

— TILMANN JAENKE

LAJMET E SHBK-SË



34-37

- > Shoqata e Bankave të Kosovës shënon Ditën Botërore të Kursimeve
- > Shoqata e Bankave të Kosovës organizon trajnimin për FATCA
- > Shoqata e Bankave të Kosovës organizon trajnimin "Menaxhimi i resurseve njerëzore për udhëheqësit e ekipeve"
- > Punëtorja Regionale për Ballkani Perëndimor: Reforma e Rregullativës Bankare dhe sfidat e së ardhmës
- > Shoqata e Bankave të Kosovës organizoi sesionin informues me temë Menaxhimi i Sigurisë Kibernetike dhe të Informacionit

38 BANKAT FUQIZOJNË SHOQËRINË

- > NLB Banka mbështet fushatën "Ti je një luledielli"
- > Raiffeisen Banka përkrah projektin kulturor për fëmijët me sindromën Down
- > Gjaku yt shpëton jetë
- > Banka Ekonomike në mbështetje të sportit

THE KOSOVO BANKER

KRYEREDAKTOR:
PETRIT BALIJA

REDAKTORE:
BLINA ZHUBI

BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

ILIR I. ALIU

Kryetar i Bordit të SHBK-së / CEO ProCredit Bank Kosovo

ROBERT WRIGHT

Zëvendëskryetar i Bordit të SHBK-së /CEO Raiffeisen Bank Kosovo

FATOS KRASNIQI

Banka Ekonomike

SUAT BAKKAL

Banka Kombëtare Tregtare

ARTON CELINA

Banka për Biznes

ALPER KARAKOÇ

IS Bank

LAVDIM KOSHUTOVA

NLB Prishtina

ORCUN OZDEMIR

TEB Bank

MERITON SUNDURI

Ziraat Bank

PETRIT BALIJA

SHBK



THE KOSOVO BANKER
MBËSHTETET NGA FONDI
EVROPIAN PËR EVROPËN
JUGLINDORE -DEVELOPMENT
FACILITY

DEKLARIMI I PËRGJEGJËSISË: Pikëpamjet e shprehura në shkrimet e revistës janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo politikat e Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore -Development Facility (EFSE-DF). SHBK dhe EFSE-DF nuk mbajnë përgjegjësi mbi përmbajtjen e artikujve të autorëve të publikuar në revistën "The Kosovo Banker".



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) është zëri i industrisë bankare në Republikën e Kosovës. SHBK është përfaqësuese e bankave komerciale të Kosovës, anëtare të SHBK, në lidhje me çështjet sektoriale bankare dhe bashkëpunon me të gjitha autoritetet përfshirë Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë, Bankën Qendrore, Institucionet Financiare Ndërkombëtare, Mediat, etj, me qëllim mbështetjen e stabilitetit dhe zhvillimit të sektorit bankar në Kosovë.

The Kosovo Banker është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy here në vit (qershor dhe dhjetor), me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. Lidhja e Pejës p.n, Zona Industriale, Prishtinë; 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

A është sukseesi
çështje që
lidhet me fluksin
e parasë?

Apo çështje
idesh?



Një kompani e suksesshme ka nevojë për të dyja: qetësi për të llogaritur dhe pasion për çështjen në dorë. Ky besim reflektohet në parimin tonë udhëheqës: 'EOS. Me mendje dhe zemër në financë'. Ky parim na shoqëron në punën tonë për kompaninë tuaj. Shërbimet tona minimizojnë nivelin tuaj të rrezikut ndaj mospagimit të kësteve, duke përmirësuar fluksin e të hollave tuaja. Kjo do të thotë se ju përfitoni nga rritja e sigurisë, keni më shumë burime për ide të reja dhe ruani suksesin në terma afatgjatë. Më shumë informacione mbi shërbimet tona mund të gjeni në www.eos-solutions.com



ILIR ALIU

KRYETAR I BORDIT TE DREJTORËVE, SHBK / CEO, PROCREDIT BANK KOSOVO

Parathënie nga Kryetari i Bordit të SHBK-së

Qendueshmeria e sektorit financiar mbetet nje nga shtyllat me thelbësore te zhvillimit ekonomik te vendit. Është e padiskutueshme që krijimi i një ambienti të mirë të investimeve që ndikon direkt në zhvillimin e biznesve afariste e varur nga qëndrueshmëria politike dhe sundimi i ligjit janë faktorët kritik që kontribuojnë në një ekonomi stabile dhe të besueshme. Megjithatë në vijim do të japë një perspektivë pozitive të ndikimit të sistemit bankar në këtë fushë.

Pas, pothuajse 20 vjet të nisjes së operimit të bankave në Kosovë, sot ky sektor është zhvilluar fuqishëm mbi bazën e funksionimit të shëndoshë dhe ofron funksionet themelore të një sistemi modern bankar. Këtu një rol të rëndësishëm ka luajtur Banka Qendrore e Kosovës, e cila përgjithësisht ka aplikuar një politikë konservative, por edhe bankat komerciale që kanë luajtur rolin e një partneri konstruktiv në këtë fushë.

Përmes një sistemi të modernizuar dhe efikas të pagesave dhe financave tregëtare, instrumenteve tjera financiare vendëse dhe ndërkombëtare, bankat në Kosovë kanë ndikuar në zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare duke e ofruar Kosovën në intergrimin e rrjetit të pagesave ndërkombëtare. Rrjedhimisht ky sistem ka siguruar lëvizjen e lirë të kapitalit në gjithë botën dhe mbi të gjitha ka kontribuar në rritjen e ekonomisë formale.

Në anën tjetër, sektori bankar në Kosovë ka siguruar një qasje të gjerë financimi në shërbim të rritjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme; Kreditë për investime në astetet fikse dhe kapital xhirues me shuma dhe maturitet relativisht fleksibil i kanë siguruar përshtatje situates financiare të ndërmarrjes, respektivisht planit të tyre të investimeve. Sot, sektori bankar ka avansuar edhe më tej kushtet e kreditimit të nxitura kryesisht nga ofertat kreditore si rezultat i rritjes së frymës konkurruese në treg. Mesatarja e normave të interest për kredi biznesi është rreth 6%, një rënie e theksuar prej 11% sa ishte pesë vite më parë. Sipas të dhënave të BQK-së vlera e përgjithshme e kredive të sektorit bankar në qershor 2018

ishte rreth 2.6 miliardë euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 11.3 për qind. Ndërsa kreditë e shpërndara për ndërmarrjet përbëjnë rreth 63,5% të kredive totale të sektorit bankar në Kosovë. Si rezultat, shuma totale e kredive bankare ndaj bruto produktit të brendshëm në Kosovë ka arritur 38,7%. Megjithatë sektori bankar duhet të ketë në fokus dhe të vazhdoj mbështjen financiare të prodhimit dhe bujqësisë, meqë konsiderojë që këta dy sektor i japin vlerë më të shtuar ekonomisë së vendit.

Megjithatë kjo do të ishte e pamundur pa fokusin strategjik të bankave në mobilizimin e depozitave nga ekonomitë familjare të Kosovës dhe bizneset. Rritja e qëndrueshme e depozitave bëri të mundur që sektori bankar të ketë mjete të mjaftueshme për shtrirjen e mëtejme të kreditimit në ekonominë e vendit, respektivisht t'i kanalizojë në investime të brendshme.

Një fushë tjetër që konsiderojë të ketë patur impakt pozitiv të sektorit bankar është edhe zhvillimi i platformave digjitale të bankimit që e kanë përafuar Kosovën me trendet ndërkombëtare të bankimit por edhe kanë nxitur bizneset të zhvillohen në aspektin teknologjik. Në këtë kontekst, vlen të theksohet rritja mjaft e madhe e pagesave të realizuara përmes llogarive bankare elektronike, të cilat në shtator të vitit 2018 arritën vlerën prej rreth 6.4 miliardë eurosh.

Ju ftoj që në këtë edicion të revistës të mësoni më shumë për zhvillimet tjera në sektorin bankar të cilat kanë bërë që ky sektor të ketë një rëndësi të veçantë në rritjen ekonomike të vendit. Gjithashtu, autorët e këtij edicioni kanë identifikuar edhe sfida të cilat me angazhime të përbashkëta dhe të koordinuara mirë mund të përmirësohen për një rritje më të madhe ekonomike në Kosovë. Në këtë edicion të revistës sektoriale The Kosovo Banker, kanë kontribuar ekspert të mirëinformuar nga sektori bankar të cilët i falenderojmë shumë. Gjithashtu falenderojmë bankat komerciale dhe EFSE DF për mbështetjen e tyre të vazhdueshme për këtë publikim të Shoqatës së Bankave të Kosovës.

**BERAT ISA**

Aktualisht shërben si Përgjegës i Thesarit, (duke përfshirë ALM dhe Tregjet e Kapitalit), në Raiffeisen Bank Kosovë. Berati ka pothuajse 20 vite eksperiencë në industrinë financiare, nga të cilat 16 vite në industrinë bankare.

Roli i bankave në zhvillimin ekonomik

Ndikimi ekonomik që bankat kanë në industrinë dhe ekonominë në të cilat ato veprojnë është thelbësor dhe ekzistencial. Bankat janë transformatorët e kursimeve në investime që pastaj kthehen sërish në kursime. Por roli i bankës është shumë më i madh se kaq. Pagesat dhe konsumi shpesh drejtohen përmes bankave, duke përfshirë eksportet, importet, si dhe, shpenzimet qeveritare kërkojnë një sistem financiar funksional. Bankat dhe institucionet tjera financiare njihen si ndërmjetës financiarë, ato sigurojnë një lidhje thelbësore midis atyre që duan të kursejnë dhe atyre që duan të marrin fonde për verpimtarit të ndryshme. Ndërmjetësit financiarë kanë njohuri të specializuara për të investuar në zona që ofrojnë kthim më të lartë dhe kjo luan rol dhe në tërheqje të depozita-

ve. Bazuar në njohuritë financiare që bankat posedojnë, ata mund t'u japin këshilla klientëve të tyre për çështjet financiare, mënyrën më të mirë për të investuar fondet e tyre, si dhe japin këshilla për mënyrat alternative për të marrë fondet financimi. Ndërsa drejtojnë fonde nga kursimtarët tek huamarrësit, bankat kryejnë të ashtuquajturin "transformim të maturitetit".

Përderisa klientët depozitues dëshirojnë qasje të menjëhershme në paratë e tyre, bankat janë në gjendje dhe dëshirojnë të japin kredi 20 vjeçarë, dmth t'u japin hua për një periudhë më afatgjatë klientëve tjerë. Ky proces krijon një mospërputhje maturiteti, duke transformuar kështu rrezikun ose të ashtuquajturin transformim të rrezikut. Ndërsa një njeri mund të jetë në gjendje të menaxhojë një ose disa



63%

**E KREDIVE AKTIVE
I PËRKASIN KORPORATAVE
JOFINANCIARE QË OPEROJNË NË
KOSOVË DHE**

36%

**NDAJ EKONOMIVE FAMILJARE /
INDIVIDËVE.**



rreziqe, menaxhimi i rrezikut financiar mund të mos jetë njëra nga këto aftësi.

Në anën tjetër, nuk mund të jeni të gatshëm t'i jepni hua drejtpërdrejtë një personi ose një kompanie, sepse ju nuk mund t'i njihni ato mirë. Bankat kanë aftësinë për të vlerësuar rreziqet dhe për të absorbuar humbje të mëdha. Prandaj bankat janë të gatshme të japin akses në paratë tuaja, duke i kredituar ato për dikë tjetër. Bankat njohin klientët e tyre, më shpesh sesa që nuk i njohin. Në shpesh përdorim sistemin për të transmetuar pagesa, për konsum, pagesa faturash të shërbimeve etj. Me këto funksione të përmendura, bankat kryejnë një rol vendimtar në shoqëri. Me rrezikun e maturitetit dhe transformimin e rrezikut dhe pagesat, bankat po marrin një sasi të konsiderueshme rreziku pasi kjo është puna e tyre.

Cili është ndikimi i Bankës në Ekonominë e Kosovës?

Bilanci i përgjithshëm i bankave në Kosovë në Gusht të vitit 2018, ka arritur në 4 miliardë Euro. Përbërja e Kredive është 2.66 miliardë Euro dhe Depozitat nga Konsumatorët 3.23 miliardë Euro. Përndryshe, PBB-ja e Kosovës pritet të jetë rreth 6.4 miliardë në vitin 2018, dhe Konsumi në Kosovë llogaritet për mbi 6 miliardë në vit dhe krijimi i kapitalit pothuajse 1.9 miliardë. Një pjesë e madhe e këtij konsumi dhe krijimi i kapitalit financohet nga Kredia e siguruar nga institucionet financiare. Gjithashtu, bankat blejnë letrat me vlerë të lëshuara nga qeveria. Kjo i ndihmon qeverisë të mbështesë shpenzimet kapitale nga qeveria dhe shpenzimet e qeverisë pastaj kanë ka efekte në zhvillimin ekonomik lokal. Nga 2.66 miliardë Euro kredi aktive në Gusht të vitit 2018

të lëshuara nga bankat në Kosovë, 63% e kredive aktive i përkasin korporatave jofinanciare që operojnë në Kosovë dhe 36% ndaj ekonomive familjare / individëve. Rritja e Konsumimit dhe Formimit të Kapitalit në PBB, si dhe kreditimi si proces ekonomik, në raport me PBB-ja janë të gusht të ndërlidhura. Mirëqenia e ekonomisë së Kosovës dhe kosovarët do të rrezikoheshin seriozisht, nëse nuk do të kishte banka për të ofruar ndërmjetësim financiar, mbështetje biznesi, prandaj ndikimi ekonomik i bankave në ekonomi është i rëndësishëm.

Qeveria mbledh një pjesë të taksave të importit në kufi, megjithatë në masë të madhe importet sigurohen përmes financimit të bankave, produkteve të financimit të tregtisë dhe shërbimit të pagesave të ofruara për furnizuesit e bizneseve të Kosovës.


| Period | GDP | Final consumption of expenditure | Final consumption of household & NPISH | Final consumption of Government | Gross capital formation | Net export | Export of goods and services | Import of goods and services | |
|-------------|-----------|----------------------------------|--|---------------------------------|-------------------------|------------|------------------------------|------------------------------|-------|
| | 1=2+5+6 | 2=3+4 | 3 | 4 | 5 | 6=7-8 | 7 | 8 | |
| 2013 | 5.326,7 | 5.331 | 4.469,16 | 836,9 | 1470,9 | (1.477,4) | 1.168,1 | 2.645,5 | |
| 2014 | 5.567,5 | 5.731,3 | 4.821,0 | 910,4 | 1.434,9 | (1.598,7) | 1.252,8 | 2.851,5 | |
| 2015 | 5.807,0 | 5.858,0 | 4.964,1 | 893,9 | 1.601,3 | (1.652,3) | 1.274,0 | 2.926,2 | |
| 2016 | 6.070,1 | 6.145,8 | 5.291,9 | 853,9 | 1.650,1 | (1.725,8) | 1.346,3 | 3.072,1 | |
| 2017 | 6.282,2 | 6.146,1 | 5.293,0 | 853,1 | 1.819,9 | (1.683,9) | 1.696,9 | 3.380,8 | |
| 2018 | Q1 | 1.298,9 | 1.404,9 | 1.195,7 | 209,1 | 346,7 | (452,7) | (452,7) | 722,8 |
| | Q2 | 1.674,6 | 1.686,2 | 1.448,9 | 237,3 | 620,5 | (632,1) | (632,1) | 968,0 |

BPV e Kosovës, Qasja e Shpenzimeve, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)



Payment Systems

(CBK data, Non Cumulative, in Mio Euros)



Sistemet e Pagesave në Kosovë

Kosova ka një sistem të fuqishëm të pagesave ndër-bankare, si dhe një rrjet të madh ATM/ POS dhe degëve, megjithëse sistemi i pagesave online dhe jo elektronike, nuk është i zhvilluar mirë. Vendi po adopton teknologji të reja, megjithatë përhapja është e ngadaltë dhe ekonomia e bazuar në para të gatshme është ende një pjesë e madhe e pagesave. Qytetarët e Kosovës mund të tërheqin mijëra euro nga ATM-të, gjë që zvogëlon aftësinë për të shitur produkte tjera, nga ana e bankave. Bazuar në grafikun e mëposhtëm, E-banking ka pasur rritje të rëndësishme në 860 milionë në muaj në Gusht të vitit 2018, krahasuar me vetëm 755 milionë në Dhjetor të vitit 2016, ose rreth 20% rritje në vëllime mujore, megjithatë bazuar në të dhënat e BQK-së, ATM-të përdoren 6 herë më shumë në vëllim mujor krahasuar me makinat POS. Në Kosovë, paratë në dorë janë ende një metodë shumë e përshtatshme e pagesës dhe është thelbësore që sistemi bankar në bashkëpunim me palët e interesuara të miratojnë një sistem të ri, në të cilin popullata Kosovare do të shtyhet në drejtim të përdorimit të mjete më moderne dhe me kosto efektive të pagesave. (Të dhënat e BQK-së të bashkangjitura)

Meqë Kosova pritet të bëjë hapa të rëndësishëm në përpjekjet e saj për pranimin në BE, ekziston mundësi reale që e gjithë sistemi i pagesave dhe e industrisë kreditore të pësojë ndryshime thelbësore, në krahasim me zhvillimet e deritanishme. Futja në SEPA, ka të ngjarë të reduktojë ndjeshëm kostot e ndërmjetësimit për pagesa. Prezantimi i PSD2 do të ofrojë gjithashtu mundësi për industrinë e IT-së, dhe industrinë tjera,

E-BANKING KA PASUR RRIJTJE TË RËNDËSISHME NË

€ 860 Milion

në muaj në Gusht të vitit 2018,

KRAHASUAR ME VETËM

€ 755 Milion

në Dhjetor të vitit 2016

20%
rritje në vëllime mujore

për të pasur qasje në menaxhimin e riskut të kredisë dhe në profilin e klientit dhe të mundësojë vlerësimin e riskut kreditor, aftësi e cila deri më tani konsiderohet si kompetencë kryesore e industrisë bankare.

Për të arritur qëllimet ekonomike, bankat kanë evoluar në mënyrë të konsiderueshme dhe kanë shpikur produkte të cilat janë ndërtuar rreth nevojave të klientit, por janë riorganizuar rreth industrisë së IT-se dhe softuerëve për të arritur këtë qëllim. Shpikja dhe përdorimi i kartelave në vitet 1960 dhe 1970 dhe më vonë vendosja e ATM-ve, zhvillimet e mëdha të kanaleve të shpërndarjes dhe rrjetet e shumta dhe të largëta të degëve, llogaria e centralizuar e klientëve dhe kontrolli i kredisë janë të gjitha “shërbimet” bankare të mundësuar nga kompjuterët dhe falë përdorimit të teknologjisë së IT-se nga bankat. Bankat kanë qenë rreth e rrotull për shekuj. Një industri që ka shpikur parane siç e njohim, si një medium shkëmbimi, historikisht një nxitës kryesor i inovacionit, mobilitetit dhe alokimit të burimeve, ka të ngjarë të ndryshojë rolet dhe industria bankare është në kulmin e adoptimit nga TI industria si një “shërbim i të dhënave” për klientët dhe asgjë më shume. A është kjo një shpagim i industrisë së TI-së ndaj industrisë bankare? apo është vetëm “krimbi i mëndafshhtë që bën metamorfozën natyrale”, dhe se bankat edhe ashtu 25 vitet e fundit, pwr shkak të mvarwsisw teknologjike, janë defakto biznese të IT-së. Industria e TI-së, një industri që nuk merr peng (duke u bazuar me fatin e industrive tjera tradicionale), mund të jetë një katastrofë për modelin tradicional bankar, sidomos për ato banka

,që nuk e miratojnë premisën: “Bankat janë vetëm një shërbim për popullatën, nga industria e TI-së”. Dikush mund të pyesë nëse ekziston një gjë e tillë si gjysmë adoptimi i teknologjisë në sistemin bankar dhe nëse mbajtja e pjesëshme e modelit ekzistues është edhe e mundur? Të paktën nuk kemi parë një shembull të suksesshëm të kësaj, as në industrinë e shitjes me pakicë apo në industrinë e muzikës. Koha do të tregojë.

Përmes dekadave, shumë industri (duke përfshirë industrinë financiare), duke adoptuar teknologjinë dhe softuerin për proceset kyçe dhe jo-kyçe, në mënyrë efektive u bënë avatarë të industrisë së IT-së, ata ishin qartë të pavetëdijshëm për këtë fakt dhe në një moment të caktuar ky ndryshim metamorfik ndodhi me një shpejtësi maramendëse por edhe në disa raste vrastare për disa biznese tradicionale. Aplikacionet dhe produktet që bien shpejt nga favori nga këndvështrimi i klientit, është “standardi” i ri. Shumica e industrive po shndërrohen në dixhitale (qëllimisht ose pa vetëdije). Ne tashmë shohim lindjen e roboadvisors (si Wealthfront, Betterment, etj), shërbimet elektronike të bazuara në pagesa dhe depozita (si Square, AliPay, Stripe, Venmo, PayPal, Apple pay, Leupay) duke ofruar po të njejtat produkte, ato që deri më tani, janë menduar si produkte bankare “tradicionale”.

Për të konsumuar një shërbim, për aq kohë sa duhet më shumë kohë për të parkuar një makinë, sa ju duhet kohë të klikoni ose të shtypni një buton, për të konsumuar të njejtin shërbim, ne e dijmë se kush do të ngadhnjejë. Investimet në facelifts, teknologji, si dhe jeta më e shkurtër e ciklit të produkteve, do të kufizojnë burimet përfundimisht nëse investimet nuk janë bërë në një mënyrë apo tjetrën, në mënyrë të duhur, për të përmbushur nevojat dhe preferencat e konsumatorëve. Industrinë, për këtë arsye, kërkohen të bëjnë hapa të shpejtë në periudha 2-4 javore në projekte zhvillimore ose inkurajohen të dështojnë shpejt, në mënyrë që të minimizohen kostot e pakthyeshme, në menaxhimin e projekteve kapitale, dhe potë njejtën kohë kërkohet që të risin agjilitetin e tyre dhe të zhvillojmë në mënyrë të vazhdueshme. Degët digjitale në objektin e tullave dhe llaçit kanë të ngjarë të rrezikohen dhe të zhduken dhe zavendësohen, nga një degë digjitale “e vërtetë” në xhepin tuaj dhe bankat që kanë bërë huqje



Suksesi i tanishëm i modelit të biznesit nuk është garanci për të ardhmen, prandaj bankat duhet të vazhdojnë të përparojnë në fusha të reja dhe të investojnë në teknologji, dhe të jenë në një gjendje konstante të përmirësimit të produkteve dhe shërbimeve.

në investime, mund të mbeten me shpenzime të mëdha të pakthyeshme. Për të reduktuar kohën e zhvillimit dhe liferimit të shërbimeve, industria e shërbimeve në TI-së është duke adoptuar teknika të reja të menaxhimit të projekteve, për të arritur këtë qëllim (korniza të ndryshme të Menaxhimit të Projekteve të Agile si p.sh. Scrum, etj). Suksesi i tanishëm i modelit të biznesit nuk është garanci për të ardhmen, prandaj bankat duhet të vazhdojnë të përparojnë në fusha të reja dhe të investojnë në teknologji, dhe të jenë në një gjendje konstante të përmirësimit të produkteve dhe shërbimeve. Është e qartë se shumica e zgjidhjeve dhe vendimeve në fushën e bankingut, rregullatives bankare apo shitjeve bankare, janë në mënyrë efektive, janë vendime për shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe monetare në lëmin të TI-së.

Shembuj të qartë dhe të suksesshëm të transformimit dixhital “të vërtetë” është industria e muzikës, lindja e industrisë online të shitjes me pakicë dhe transformimi digjital i shumicës së bizneseve në B2B në industri të ndryshme. Në të vërtetë, një “grusht shteti” i heshtur nga industria e IT-së ndaj të gjitha industrive të tjera, të cilat kanë tendencë t’i shpëtojnë ato industri, fillimisht duke i shpjer ato buzë greminës së shkatrimit. Shembulli më i kjartë i kësaj është industria e muzikës dhe filmit nga dekada e kaluar, e cila u shpëtua nga paraqitja e Apple iTunes, më vonë nga shërbimet streaming si Spotify, Netflix, (video dhe audio) dhe reklamimi online, por ky “shpëtim” ndodhi pasi që, fillimisht, puthuajse u shkatërrua tërësisht si industri, nga shpërndarjet ilegale të skedarëve “pear to pear” në internet. Industria e IT-së ka zhveftësuar ndërmjetësimin si burim të ardhurash për shumë industri, dhe ka rritur konkurrencën për të mirën e konsumatorit në shumë industri, veçanërisht në 25 vitet e fundit. Teknologjitë e reja e kanë bërë jetën më të lehtë për konsumatorin, në shumë fusha, duke përfshirë edhe konsumatorët në sistemin bankar. Bankat duke përfshirë bankat në Kosovë po përpiqen të luftojnë jo vetëm sfidën e industrisë IT-së, por edhe të plotësojnë këkesat rregullatore në rritje, si dhe kërkemat mjedisore të tjera, dhe duke e bërë këtë, bankat duhet të mos harrojnë rolin shumë të rëndësishëm ekonomik që e kanë.

Referencat:

Dokumentacion të ndryshëm
Faqja e internetit e BQK-së, seritë e të dhënave
ASK Kosovo

**ANITA KOSUMI AJETI**

Udhëheqëse e Departamentit të Burimeve Njerëzore
Banka për Biznes

Zhvillimi i burimeve njerëzore në sektorin bankar

Sektori bankar ballafaqohet me sfida të ndryshme sa i përket trendeve të burimeve njerëzore si identifikimin e kandidatëve të duhur, punësimin, mbajtjen dhe motivimin e tyre. Tranzicioni digjital në sistemin bankar padyshim që ka afektuar edhe fuqinë punëtore. Niveli i kompetencave të të punësuarve kërkohet të jetë sa më i avancuar në mënyrë që banka të zhvillohet dhe të jetë në hap me trendet botërore sa i përket digjitalizimit dhe ngritjes së efikasitetit në shërbimet bankare.

Në këtë aspekt, është shumë me rëndësi që të punësuarit të specializohen në fusha të reja dhe të investojnë në njohuri apo aftësi specifike të fushës së teknologjisë si dhe të jenë të orientuar drejt shërbimit të shkëlqyeshëm ndaj klientëve.

PUNËSIMI DHE ZHVILLIMI I TË RINJVE NË SEKTORIN BANKAR

Punësimi dhe zhvillimi i të rinjve në përgjithësi dhe në sektorin bankar në veçanti janë sfida të vazhdueshme në vendin tonë.

Bashkëpunimi i bankave me Universitetet si dhe identifikimi i nevojave të zhvillimit në sektorin bankar, janë faktor shumë të rëndësishëm për të ju ndihmuar të rinjve të fillojnë karrierën



Punësimi dhe zhvillimi i të rinjve në përgjithësi dhe në sektorin bankar në veçanti janë sfida të vazhdueshme në vendin tonë.

e tyre në këtë sektor. Zhvillimi i tyre me frymën e sjelljes së inovacionit, investimi në zhvillimin e kompetencave të nevojshme për të ardhmen si dhe rritja e bashkëpunimit Universitet / Banka janë vetëm disa nga fushat e benefiteve që kemi nga punësimi i të rinjve.

Në këtë drejtim, ne kemi kontribuar në identifikimin e studentëve, trajnimin dhe punësimin e tyre në profilet për të cilat është vlerësuar se kanë potencial.

Gjatë procesit të integritetit të të rinjve, rëndësi e veçantë i është kushtuar trajnimit të tyre rreth etikës së punës në bankë dhe inkurajimin për sjelljen



Rekrutimi i profileve adekuate si dhe trajnimi dhe zhvillimi i tyre, janë fushat kyqe përmes të cilave ne kemi realizuar planin strategjik të Bankës



Niveli i kompetencave të të punësuarve kërkohet të jetë sa më i avancuar në mënyrë që banka të zhvillohet dhe të jetë në hap me trendet botërore sa i përket digjitalizimit dhe ngritjes së efikasitetit në shërbimet bankare.

e ideve inovative për ndryshime, për të vazhduar pastaj me trajnimet specifike të fushave të ndryshme të sektorit bankar. Përvoja e sjellë në trajnim nga Menaxhmenti i Bankës si dhe të punësuarit me përvojë të gjatë bankare, ka ndihmuar shumë në orientimin e studentëve drejt përzgjedhjes së fillimit të karrierës së tyre në sektorin bankar.

Ndër të tjera, përmes Programit BPB Juniors, ne kemi zhvilluar një program të mirëfilltë të përgjegjësisë shoqërore korporative me fokus në studentët dhe zhvillimin e tyre, duke fuqizuar bashkëpunimin profesional me Universitete.

ROLI I TË PUNËSUARVE NË ARRITJET TONA

Realizimi i strategjisë si dhe rritja e dy viteve të fundit në Bankën tonë, është bërë e mundur falë angazhimit dhe produktivitetit të të punësuarve të Bankës të cilët me ngritjen e kualitetit në shërbimet bankare dhe kujdesin ndaj klientëve, kanë bërë të mundur realizimin e strategjisë si dhe na japin mundësinë të aspirojmë për rritje dhe zhvillim të mëtutjeshëm. Plani i karrierës ka ndikuar në promovimin dhe avansimin në karrierë për të punësuarit me performancë të shkëlqyer, me qëllim motivimin, zhvillimin profesional dhe afatgjatë të tyre

në Bankën tonë. Përmes komunikimit dhe promovimit të aspiratave tona për rritje, zhvillim dhe inovacion ne kemi promovuar vlerat e Bankës të cilat mbrohen dhe respektohen nga çdo i punësuar si integriteti, përkushtimi, transparenca, puna ekipore, orientimi drejt zhvillimit, inovacioneve si dhe kujdesi ndaj klientëve.

Rekrutimi i profileve adekuate si dhe trajnimi dhe zhvillimi i tyre, janë fushat kyqe përmes të cilave ne kemi realizuar planin strategjik të Bankës, gjithmonë duke ofruar ambient pune që të punësuarit të jenë të motivuar për ndryshime dhe inovacion.

**DR. JOHANNES ENGELS**

(Autori është anëtar i Akademisë VDSSt dhe Ligjërues në Shkollat e Aplikuara të Shkencave në Mainz dhe në Worms. Ai në këtë kontekst thekson vetëm opinionin e tij privat).

Bankat dhe Zhvillimi Ekonomik - le t'i bëjmë ato të gatshme për të Ardhmen!

1

BANKAT SI LINJË E RËNDËSISHME PËR NDËRMJETËSIMIN EKONOMIK.

Është absolutisht e vërtetë që bankat luajnë një rol vendimtar në zhvillimin ekonomik të vendeve në mbarë botën. Për komunitetin lokal, institucionet e kredive sigurojnë qasje në fonde dhe shërbime financiare për bizneset vendore dhe qytetarët, si dhe bankat e parasë investojnë përsëri në komunitet përmes listës së pagave të punonjësve, investimeve të biznesit dhe taksave. Në një shkallë më të gjerë, bankat kombëtare ofrojnë qasje të ngjashme në kredi dhe shërbime financiare për bineset më të mëdha, qeveritë lokale dhe në disa raste edhe për klientët ndërkombëtarë. Investimet e bëra nga bankat kombëtare janë të përhapura gjerësisht në të gjithë vendin, duke ndikuar kështu në zhvillimin ekonomik në të gjithë vendin ose rajonin gjeografik.

Roli specifik i bankave në zhvillimin ekonomik ndryshon varësisht nga fushëveprimi. Kryesisht, pjesëmarrja e bankave në zhvillimin ekonomik fokusohet në sigurimin e kredive dhe shërbimeve për gjenerimin e të ardhurave, të cilat pastaj kthehen në komunitet lokal, kombëtar ose ndërkombëtar.

Rolet specifike që luajnë bankat në zhvillimin ekonomik të një komuniteti të vogël ndryshojnë nga roli që bankat luajnë në zhvillimin ekonomik kombëtar ose ndërkombëtar. Edhe pse roli mund të ndryshojë, faktorë të tillë si qasja në kredi dhe politikat ose praktikat e investimeve bankare mbeten konstante, pavarësisht fushëveprimit të zhvillimit ekonomik. Pra, institucionet e kredive mund të jenë partnerë të rëndësishëm dhe të vlefshëm në botën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe gjithashtu për personat fizikë. Në Gjermani, bankat rajonale si bankat e kursimit dhe kooperativat japin një shembull të shkëlqyer për këtë. Nga ana tjetër, bankat ndërkombëtare ndikojnë në zhvillimin ekonomik në një shkallë të madhe. Një bankë që bën biznes në nivel ndërkombëtar luan një rol të ndryshëm nga bankat lokale ose kombëtare në zhvillimin ekonomik. Sigurimi i kredive dhe shërbimeve të tjera financiare për të gjithë shtetet dhe qeveritë kombëtare u jep bankave të tilla një ndikim të gjerë mbi rritjen ekonomike të një vendi apo rajoni të caktuar. Të dy efektet pozitive dhe negative janë realizuar, varësisht nga veprimet e bankave ndërkombëtare ndaj qeverive.

2

NJERËZIT QË PUNOJNË NË INSTITUCIONET KREDIDHËNËSE GABIMET MUND TË NDODHIN

Bota është, siç e dinë të gjithë, jo e përsosur. Nën një shumë krizash të tjera financiare, kriza e fundit, e njohur si kriza subprime, tregon qartë se edhe në industrinë bankare gabimet mund të ndodhin. Vështirësitë ekonomike të shekullit të 21-të japin një shembull kryesor të rolit negativ të mundshëm të bankave në zhvillimin ekonomik. Shumë vende përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Europës, përjetuan një ngadalësim të rritjes ekonomike në fillim të shekullit të 21-të. Faktorë të shumtë si papunësia e lartë, performanca e keqe e investimeve dhe pasiguria politike ndihmuan në krijimin e një mjedisi të mosbesimit dhe zvogëlimit të besimit midis bankave ndërkombëtare dhe qeverive me ekonomi të mëparshme të forta kombëtare.


Kjo rezultoi në reduktimin e renditjes së kredive të disa vendeve dhe rritjen e normave të interesit për kredinë e zgjatur ndaj këtyre qeverive. Kostot e tilla në rritje u përhapën, duke rritur normat e interesit për kreditë qeveritare për bizneset dhe individët dhe duke zvogëluar fondet në dispozicion për

programe socio-ekonomike si arsimi dhe kujdesi shëndetësor. 1)

Kriza e pengut subprime, e cila filloi në 2007/2008, buronte nga një zgjerim më i hershëm i kredisë së pengut, duke përfshirë edhe huamarrësit të cilët më parë do të kishin vështirësi në marrjen e pengut të cilat kontribuan dhe lehtësuan që çmimet e shtëpive të rriten. Historikisht, blerësit e mundshëm të shtëpive kanë pasur vështirësi për të marrë peng, nëse ata kishin historitë e kreditimit nën mesataren, me kusht që të paguanjë pagesa të vogla ose kërkonin kredi me pagesë të lartë. Nëse nuk mbrohet nga sigurimi qeveritar, huadhënësit shpesh mohojnë kërkesat e tilla të pengut. Ndërkohë që disa familje me rrezik të lartë mund të merrnin peng të vogël të mbështetur nga Administrata Federale e Strehimit (AFS), të tjerë, përballë mundësive të kufizuara të kredisë, i merrnin me qira. Në atë epokë, pronësia e shtëpive luhtej rreth 65%, normat e konfiskimit të pengut ishin të ulëta, dhe ndërtimi i shtëpive dhe çmimet të shtëpive kryesisht reflektonin lëkundjet në normat e interesit në peng dhe të ardhurat.

Kur çmimet e shtëpive arritën kulmin, rfinansimi i pengut dhe shitja e shtëpive u bënë mjete më pak të qëndrueshme për zgjidhjen e borxhit të pengut dhe normat e humbjeve të pengut filluan të rriten për huadhënësit dhe investitorët. Në prill të vitit 2007, New Century Financial Corp., një huadhënës kryesor i pengut subprim, paraqiti falimentimin. Pak kohë pas kësaj, një numër i madh i letrave me vlerë të mbështetura nga tregu subprim u reduktuan në rrezik të lartë dhe disa huadhënës subprim u mbyllën. Për shkak se financimi i obligacioneve të pengut subprim u shemb, huadhënësit ndërprenë marrjen e pengut subprim dhe të pengut të tjera të cilat ishin jo të favorshme. Kjo uli kërkesën për strehim,

duke çuar në uljen e çmimeve të banesave, gjë që nxiti pritjet e rënies akoma më shumë, duke ulur më tej kërkesën për shtëpi. Çmimet ranë aq shumë sa që u bë e vështirë për huamarrësit e trazuar që t'i shesin shtëpitë e tyre për të paguar plotësisht pengun e tyre, edhe nëse ata kishin dhënë një pagesë të konsiderueshme. 2)



3

KËRKESAT E REJA TË BASEL III.5 TË KUALIFIKUAR SI MASA TË SIGURISË NË KONTEKSTIN E SIPËRPERMENDUR

Mësim nga këto kriza, në vijim sipas ekspertëve bankarë të njohur rregullat e Basel III u rrit si pikë kryesore sasinë e kapitalit që duhet të mbajnë bankat, dhe të vendosë një radhë bazë të nivelit të kapitalit prej 6%. Përveç kësaj, bankat duhet të vënë para në një amortizator konvergimi kapital prej 2.5% dhe një amortizator anti-ciklik deri në 2.5% varësisht nga zhvillimi. Lirisht e motivuar nga: "Kurseni para në kohë të mira dhe do të keni para në kohë të këqija!" (Ka shumë për të aplikuar pasi Republika e Kosovës i takon numrit të vendeve që nuk janë në BE, të cilat janë të përditësuara në atë kontekst - autori). Afati i implementimit teknik për Basel III është në vitin 2019, por zhvillimet e fundit në tregun bankar kanë sugjeruar që rregullat më strikte mund të zbatohen nga një kornizë e mëvonshme, e quajtur "Basel III.5" (ose "Basel IV"). Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare lëshoi një dokument konsultativ, duke kërkuar pikëpamje mbi planin e Komitetit për të ndryshuar se si llogariten kërkesat e kapitalit dhe rreziqet e tregut. 3)

Ky emër i Bazelit III.5 është një term kontestues për ndryshimet e rëna dakord në 2016 dhe 2017 në standardet ndërkombëtare bankare të njohura si Marrëveshjet e Bazelit; rregullatorët argumentojnë se këto ndryshime thjesht po kompletojnë reformat e Basel III, të dakorduara në parim në vitet 2010-11, megjithëse shumica e reformave të Basel III u miratuan në detaje në atë kohë. Kritikët e reformës, veçanërisht ata të industrisë bankare, argumentojnë se Basel III.5 kërkon një rritje të ndjeshme në kapital dhe duhet të trajtohet si një rund i veçantë reformash. 4)

Kjo "paketë" Basel III.5 paraqet ndryshime që kufizojnë reduktimin e kapitalit që mund të rezultojë nga përdorimi i modeleve të brendshme të bankave nën qasjen e bazuar në vlerësimet e brendshme. Kjo përfshin në një pasqyrë të shkurtër:

- Një shtresë të standardizuar, në mënyrë që kërkesa për kapital gjithmonë të jetë të paktën 72.5% e kërkesës sipas qasjes së standardizuar;
- Një reduktim i njëkohshëm në peshat e rrezikut të standardizuara për kreditë e pengut me rrezik të ulët;
- Kërkimi i bankave për të arritur raporte maksimale të levave maksimale (një raport fillestar i levave maksimale ka të ngjarë të përcaktohet si pjesë e përfundimit të paketës Basel III);
- Një raport më i lartë i levave për Bankat me Rëndësi Sistematike Globale (BRSG), me rritje të barabartë me 50% të raportit të kapitalit të rregulluar nga rreziku
- Dhënia më e detajuar e rezervave dhe statistikave të tjera financiare. 5)

Nuk duhet të harrohet ideja e rekomanduar për zbatimin e të ashtuquajturit hap në rrezik, që do të thotë të integrohen aktorët e pa mbikëqyrur nën kulmin e mbikëqyrjes, kur janë partnerë të rëndësishëm në fushën e shërbimeve bankare ("bankat e hijes" - autori).

Është absolutisht e vërtetë, se institucionet e kreditit nuk duhet të përballen me një "ecje të lehtë" në të ardhmen. Sipas të tjerëve, vetëm bankat britanike mund të kenë nevojë të rrisin 50 miliar-

dë paund në kapital për të përmbushur kërkesat e Basel III.5. Raporti mesatar i kapitalit të zakonshëm për bankat e mëdha Europiane vlerësohet të bie për 0.9%, me ndikimin më të madh në bankat në Suedi dhe Danimarkë prej 2.5% - 3%. 6)

Dhe vetëm kjo e mbyll rrethin: tema kryesore e ditëve të sotme Basel III.5 përsëri nuk është një mbikëqyrje burokratike dhe mbyltesë, por një mbikëqyrje drejtuese në shoqërimin e institucioneve të kreditit nga - në hyrje të emëruar - përgjegjësia për të luajtur një rol vendimtar në zhvillimin ekonomik të vendeve në mbarë botën.

Referencat:

1) WiseGEEK: "Cili është Roli i Bankave në Zhvillimin Ekonomik?" Informacioni në Internet. Marrë në 8 tetor 2018.

2) Bernanke, Ben S., "Një shekull i Bankingut Qendror Amerikan: Qëllimet, Kornizat, Përgjegjshmëria". Fjala e dhënë në "100 vitet e para të Rezervës Federale: Regjistrimi i Politikave, Mësimet e Mësuara dhe Perspektivat për të Ardhmen" në 10 Korrik 2013.

3) Moneybeat: "KPMG paralajmëron mbi 50 miliardë funta" Basel 4 "Vrima Kapitale". Marrë 18 maj 2014.

4) Instituti i Kontabilistëve në Angli dhe Uells: "Rregullatorët shikojnë përpara në" Basel 4 ". Marrë 18 Maj 2014.

5) blogs.deloitte.ch: "Pesë gjëra për të kujtuar për Basel III - Banking blog". Marrë në 1 shtator 2018.

6) International Business Times: "KPMG: Bankat në Mbretërinë e Bashkuar përballen me 50 miliardë funte Vrima Kapitale si" Basel IV "Del", botuar më 12 shtator 2013. Marrë nga 18 maj 2014.



ELVIS ZIU, MBA, CA, LA

Evolucioni i shpejtë i modelit të biznesit Bankar në vitet e paskrizës


Në këto 7 shekuj industria bankare ka pësuar vazhdimisht rritje dhe ka qënë një pjesë thelbësore e zhvillimit të sistemeve ekonomike. Megjithatë kriza e fundit financiare tronditi jo vetëm themelet financiare të sistemit por pati dhe ndikime të shumëfishta në modelin e biznesit:

NË RRADHË TË PARË, pas krizës u ngadalësua kreditimi. Nëse shihet raporti i kredive me depozitat në Europë, mund të dallohet qartë që rënia që ka filluar në kohën e krizës (kur raporti ishte mbi 140%) ka vazhduar deri tani (në nivelet pak më lart se 100%):


KY NGADALËSIM PATI 2 EFEKTE KRYESORE:

- Ndryshoi modelin e të ardhurave duke ulur ato të interesit e duke rritur ato të shërbimeve (sipas McKinsey tashmë kanë kaluar 1/3 e të ardhurave)

Nëse shihet raporti i kredive me depozitat në Europë, mund të dallohet qartë që rënia që ka filluar në kohën e krizës (kur raporti ishte mbi 140%) ka vazhduar deri tani (në nivelet pak më lart se 100%):



LOAN-TO-DEPOSIT RATIO



● U krijuan hapësira për lojtarë të tjerë në tregun e financimit si: modelet P2P, financimi me krypomonedha apo instrumenta e skema të tjera me bazë financim asetesh.


EFEKT I DYTË I KRIZËS ishte shtimi i ndjeshëm i kërkesave rregullative. Këto kërkesa goditën performancën e bankave në 3 drejtime:

● Rritja e rezervave për mbulimin e riskut

● Shtimi i kosotove operative (Psh. Deutsche Bank shtoi kosto me rreth USD 1.8 billion)

● Shtimi i gjobave për mos-perputhje (45 fish rritje e raportuar ne USA) etj. Gjithashtu, një efekt tjetër ishte sponstimi i vemendjes menaxheriale nga fokusi i zhvillimit të modelit të biznesit.

% OF CLIENTS THAT UTILIZE ONLINE BANKING



SË TRETË, është transformimi i proceseve si pasojë e teknikeve të reja menaxheriale por dhe me ndihmën e teknologjise. Në këtë aspekt, në vijim të krizës e për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit dhe operacioneve shumë banka zhvilluan (apo po zhvillojnë) projekte në:

- Ri-organizim të strukturave menaxheriale dhe operacionale
- Ri-inxhinierizim të proceseve kritike
- Dixhitalizim të të dhënave dhe automatizim të proceseve të punës.
- Sofistikim të analizës së të dhënave
- Përmirësim të sistemeve të ndërlidhjes me klientes (CRM), etj.

Më rishtazi, ka dhe një rritje të investimeve në teknologji të reja si psh. 91% e Bankave raporton se po bënë investime në Blockchain dhe 77% në sisteme të Inteligjencës Artificiale.



Me evolucionin e teknologjike avantazhi konkurrues krijohet sidomos përmes aftësisë për të kuptuar konsumatorin dhe për të krijuar lidhje domethënëse me të. Ky avantazh i kalon kufijtë industrialë. Konglomerate të teknologjisë apo të komunikimit si Amazon, Apple, Facebook etj. konkurojnë tashmë në tregje që tejkalojnë kufijtë e industrive të tyre si psh. në prodhim, shërbime financiare, shërbime konsulence, shërbime reklamimi, transporti, informimi etj.

SË KATËRTI dhe efekti ndoshta më i ndjeshëm është dhe rritja drastike në përdorimin e teknologjise nga konsumatori. % of clients that utilize online Banking


Në Europë tashme me tepër se gjysma e klientëve janë përdorues të bankingut online (në disa vendet Danimarka, Holanda etj. kjo shifër shkon në nivelet e 90%). Ofrimi i shërbimeve online është bërë një nga kushtet kryesore për klientët për të zgjedhur bankën e tyre.



Në analizën e bërë në tregun Amerikan në vitin e kaluar kjo është frekuenca e përdorimit mujor të kanaleve bankare që rezultoi:

Duket qartë që frekuenca e përdorimit të degëve është mjaft e ulët krahasuar me kanalet online. Sigurisht dicka tjetër që bie në sy është tendenca e brezit të ri (Millennials) në drejtim të:

1. Shtimit të përdorimit të kanaleve online në tërësi
2. Rritjen e kanalit përmes celularit

FREQUENCY OF USE OF BANKING CHANNELS (US)





Gjithashtu ndërrimi i brezave pritet të shoqërohet me uljen e besnikërisë ndaj një banke të caktuar, një karakteristikë kjo e brezit më të vjetër.

NEVOJA PËR EVOLUIM TË SHPEJTË

Të gjitha sa më sipër kanë pasur ndikim kolosal në biznesin bankar duke ndikuar transformime që kishin dekada që nuk ndodhnin. Bankat kanë filluar të ndryshojnë. Kjo duket dhe në raportin e fundit të Federatës Europiane të Bankave ku raportohet një rënie e theksuar e rrjetit të degëve dhe personelit në sektorin bankar Europian. **MEGJITHATË, MBETEN DISA SFIDA PËR TU ADRESUAR ME SHPEJTËSI:**

1. Konkurenca për cilësi shërbimi:

Në vitet e fundit kompanitë e tipit Fintech, falë ADN-së së tyre teknologjike zhvilluan produkte inovative duke arritur të shfrytëzojnë hapësirën e krijuar nga procese të shërbimeve apo produkteve bankare ku bankat janë më të ngadalta apo më të kushtueshme.



Bankat duhet të operojnë me të njëjtin parim që të arrijnë të jenë efektive në ndjekjen e nevojave të klientëve të tyre.

Bankat duhet ti kthehen inovacionit dhe të adresojnë mungesën e efikasitetit në procese që lidhen me klientin për të arritur që të udhëheqin konkurrencën për cilësi apo kosto shërbimi.

2. Format e reja të ndërmjetësimit:

Modelet e ndërmjetësimit inovativ si P2P, kryptomonedhave etj. kanë parë një zhvillim shumë të shpejtë (kryptomonedhat kanë tejkaluar USD 500 billion). Ato përbëjnë sfida si për bankat dhe rregullatorët në ruajtjen e stabilitetit financiar.

Megjithatë, këto përpjekje demostrojnë një kërkesë në rritje të konsumatorit për forma të reja të ndërmjetësimit. Duhet që bankat të adaptohen që të jenë në gjendje të adresojnë këtë nevojë dhe që trajtojnë riskun dhe financimin nën modele më fleksibël dhe duke krijuar një lidhje të re mes pritshmëritë ekonomike dhe resurseve financiare.



3. Eksperinca konsumatore dhe multikanalet:

Në pothuaj cdo industri sot po ndodh një transformim thelbësor në dy aspekte:

- Klientët krijojnë lidhje me kompanitë apo produktet e tyre gjithnjë e më tepër si pasoje e një experience pozitive ndërveprimi. Kjo ka brenda elemente vlere ekonomike por dhe kërkesën për ndërveprim të personalizuar.
- Klientët duan zgjedhje në kanale. Ata nuk duan që kanalet nga do ti blejnë shërbimet / produktet të jenë të kufizuara apo të imponuara dhe duan kanale efektive dhe disponibel në cdo kohë.

Bankat duhet të operojnë me të njëjtin parim që të arrijnë të jenë efektive në ndjekjen e nevojave të klientëve të tyre.

4. Rënia e mureve të konkurrencës ndër-industriale

Me evolucionin e teknologjike avantazhi konkurues krijohet sidomos përmes aftësisë për të kuptuar konsumatorin dhe për të krijuar lidhje domethënëse me të. Ky avantazh i kalon kufijtë industrialë. Konglomerate të teknologjisë apo të komunikimit si Amazon, Apple, Facebook etj. konkurojnë tashmë në tregje që tejkalojnë kufijtë e industrive të tyre si psh. në prodhim, shërbime

financiare, shërbime konsulence, shërbime reklamimi, transporti, informimi etj.

Këto kompani përmes të dhënave dhe kanaleve të shitjes që zotërojnë kanë filluar të krijojnë një lloj të ri lojtari në tregjet e shërbimeve financiare – të ashtuquajturat TechFin. TeckFin-et, nuk kanë për qëllim të shfrytëzojnë inefficencën të përkoheshme në proceset bankare por të ndryshojnë modelin e biznesit duke konkuruar me Bankat me armë që ato tashmë i zotërojnë:

- besueshmërinë dhe markën,
- kanale massive dhe efektive shpërndarjeje,
- zotërim dhe kontroll mbi një sasi të madhe transakcionesh,
- rolin ndërmjetësues që kanë mes shitësit dhe blerësit,
- të dhënat masive mbi sjelljen konsumatore që mund të shfrytëzohen për profilizime të riskut kreditor apo vendosjen e cimitit të produkteve financiare etj.

Të gjitha këto sfida tregojnë që evolucionin e sistemit Bankar tashmë ka hyrë në një fazë të re dhe mjaft konkurrenciale.

Mbetet që bankat të përshpejtojnë projektet e tyre transformuese me një vizion të qartë nga një e ardhme që shtron shumë sfida dhe focusin në një profil të ri konsumatori që është gjithnjë e më shumë kërkues.



KATERINA BOSEVSKA
DREJTORE MENAXHUES
EOS MAQEDONI, KOSOVË DHE MALI I ZI

PRAKTIKAT E PAGESAVE NË TË GJITHË EVROPËN:

Pagesat e vonuara dhe mos pagesa e tyre vënë në rrezik mbijetesën e sipërmarrjes

Ka një tendencë pozitive në gatishmërinë për të paguar me kohë në mesin e klientëve në të gjithë Evropën, por ende ka vend për përmirësim, pasi çdo e pesta faturë e lëshuar ndikohet nga vonesat në pagesë. Pagesat e vonuara dhe mos pagesa e tyre vë disa kompani evropiane në kërcënim të ekzistencës së tyre. Kjo është ajo që zbulon anketa e EOS “Praktikat Evropiane të Pagesave” 2018.

Çdo vit për 11 vitet e fundit Grupi EOS së bashku me institutin e pavarur të hulumtimit të tregut Kantar TNS (ish TNS Infratest) kryen “Studimin e Praktikave të Pagesave Evropiane” që synojnë kompanitë evropiane. Anketa e këtij viti (2018) tregon tendencë pozitive për Evropën krahasuar me vitin e kaluar dhe konfirmon një prirje pesëvjeçare të gatishmërisë në rritje për të paguar në kohë. Anketa tregon se në vitin 2018, 79 përqind e faturave paguhet me kohë, krahasuar me 75 përqind në vitin 2014. Sidoqoftë, në

përgjithësi në Evropë, afati i pagesës, megjithëse i shkurtuar në krahasim me vitin 2014 (afati i pagesave prej 37 ditësh), është ende shumë i gjatë duke llogaritur 34 ditë mesatarisht pas lëshimit të faturave.

Për më tepër, anketa zbulon se 18 përqind e faturave në Evropë vazhdojnë të paguhet me vonesë me një kohë mesatare prej 20 ditësh pas datës së caktuar. Në përgjithësi, vendet e Evropës Lindore janë më të prekur nga problemi i pagesave të vonuara se sa vendet e Evropës Perëndimore. Për shembull, në Greqi dhe Poloni vetëm 74 përqind e të gjitha faturave paguhet në kohë, krahasuar me 85 përqind në Danimarkë dhe 82 përqind në Gjermani, Zvicër dhe Spanjë.

Pasi që çdo faturë e pestë nuk paguhet me kohë në Evropë, vonesat e pagesës janë ende pjesë e rutinës ditore për kompanitë. Arsyet për pagesat e vonuara, sipas të anketuarëve, ndryshojnë nga problemet e rrjedhës së përkohshme të parasë (59%) ndaj



ANKETA ZBULON SE

18%

PËRQIND E FATURAVE NË EVROPË VAZHDOJNË TË PAGUHEN ME VONESË ME NJË KOHË MESATARE PREJ 20 DITËSH PAS DATËS SË CAKTUAR.



mospagesës së qëllimshme (34%) për klientët privatë dhe faktorë shtesë si mungesa e kapaciteteve (40%), gabimi njerëzor (33%) ose arsye teknike (27%) për klientët e biznesit. Përveç kësaj, 3 përqind e të gjitha faturave të papaguara në Evropë nuk paguhen fare, me një përqindje më të lartë për rajonin e Ballkanit (4% për Bullgarinë dhe 5% për Kroacinë).

Në Evropë ende preferohen metodat e pagesave konvencionale

Kompanitë Evropiane ofrojnë mesatarisht 4.1 opsione të pagesës, shumica prej të cilave janë tradicionale. Studiimi i EOS zbulon se vetëm 29 përqind e kompanive ofrojnë metoda moderne të pagesave. Vetëm 5 përqind ofrojnë pagesa të lëvizshme si një opsion dhe


70%

**TË GJITHA KOMPANIVE
NË EVROPË QË PËRDORIN
MENAXHIMIN E JASHTËM TË
ARKËTIMEVE BIEN DAKORD QË
KOMPANITË PËR MBLEDHJEN
E BORXHEVE TË INKURAJONJË
PRAKTIKAT E MIRA TË PAGESAVE
NË SHOQËRI**

megjithëse bota është absorbuar nga kripto monedhat, vetëm 1 për qind e kompanive e ofrojnë këtë si një opsion pagese. Rreth 91% e kompanive të anketuara thonë se është jashtë diskutimit implementimi i kësaj si një metodë pagese në të ardhmen.

Metodat konvencionale të përdorura kryesisht janë transfertat bankare (82%) dhe blerjet në llogari (64%) që përdoren shumë në Evropën Perëndimore (73%), por shumë më pak janë të përdorura në Europën Lindore (59%) - edhe pse kjo është metoda më e përdorur në Poloni (90%). Pagesat në para të gatshme ofrohen ende nga më shumë se një e treta e kompanive evropiane (39%), me një përqindje më të lartë në rajonin e Ballkanit (41% në Bullgari dhe 48% në Kroaci).

CONVENTIONAL METHODS



82%

BANK TRANSFER



64%

PURCHASE ON ACCOUNT



52%

ADVANCE PAYMENT



33%

INSTALLMENT PLAN



64%

CREDIT CARD



29%

DIRECT DEBIT

Pothuajse çdo e shtata kompani në Evropë ka frikë për ekzistencën e saj

Për shkak të vonesave në pagesa, shumë kompani evropiane gjejnë veten në vështirësi financiare. Studimi i EOS zbulon se humbjet e fitimit dhe mungesat e likuiditetit janë efektet më të shpeshta të pagesës së vonuar midis kompanive evropiane. Gjegjesisht, 42 përqind e të gjitha kompanive të anketuara kanë raportuar një ulje të fitimeve dhe 38 përqind janë përballur me probleme të rrjedhës së parasë. Kompanitë duhet të marrin masa brenda vendit për t'u përgjigjur efekteve negative të pagesave të vonuara dhe të parregullta, të cilat përfshinin: rënien e investimeve (23%), ngrirjen e rekrutimit (19%) dhe rritjen e çmimeve (18%). Nga grupi i kompanive të anketuara 14 përqind thanë se po përballen me një kërcënim të ekzistencës së tyre. Kjo përq-

indje ka pësuar një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2017, kur ishte 17 përqind, por ende nënkupton që pothuajse çdo e shtata kompani në Evropë ka frikë se vonesat në pagesa mund të rrezikojnë ekzistencën e saj, gjë që mund të ketë implikime të rënda ekonomike.

Agjencitë profesionale të mbledhjes së borxheve mund të ndihmojnë

Kompanitë e mbledhjes së borxheve ndihmojnë klientët e tyre për të minimizuar vonesat e pagesave dhe mosparaqitjet dhe gjithashtu të sigurojnë që firmat të marrin pagesa të papaguara më shpejt. Duke vepruar kështu, ato japin një kontribut të rëndësishëm në të gjithë ciklin ekonomik. Duke rritur likuiditetin e kompanive dhe duke përmirësuar kapacitetin e inovacionit, ato mbrojnë vendet e punës.

Në të vërtetë, rreth 37 përqind nga të gjitha kompanitë evropiane punojnë me kompanitë për mbledhjen e borxheve si EOS, gjë që arrin që 9% e të ardhurave totale të kthehet në rrjedhën e parasë të kompanisë. Kompanitë e anketuara thonë se atëherë ata përdorin paratë për shlyerjen e detyrimeve (61%), ruajtjen / krijimin e vendeve të punës (47%), zgjerimin e segmentit të biznesit (35%), hulumtimin dhe zhvillimin (27%) dhe investimin në tregun financiar (25%).

Rreth 70 përqind e të gjitha kompanive në Evropë që përdorin menaxhimin e jashtëm të arkëtimeve bien dakord që kompanitë për mbledhjen e borxheve të inkurajojnë praktikatat e mira të pagesave në shoqëri. Kompanitë profesionale të mbledhjes së borxhit konsiderohen si opsion më i mirë në krahasim me proceset e mbledhjes së borxhit të brendshëm,

MODERN METHODS



52%
CASH PAYMENT



26%
DEBITEC CARD



23%
ONLINE TRANSFER
VIA THIRD PART
PROVIDER



82%
eWALLET



5%
MOBILE PAYMENT



1%
CRYPTO CYRRENCY

ndër të tjera, sepse ato janë të përqendruara vetëm në procesin e mbledhjes, që do të thotë ndjekjen e tendencave dhe sfidave më të reja në menaxhimin e arkëtimit. Për shembull, rreth 45 përqind nga kompanitë e anketuara, e shohin mbajtjen e hapit me ndryshimet teknologjike si një nga sfidat kryesore në menaxhimin e arkëtimit deri në vitin 2020. Sfidat tjera të rëndësishme janë trajnimi i punonjësve (48%), reduktimi i shpenzimeve (49%), digjitalizimi / automatizimi i proceseve (43%), investimet në zgjidhjet e IT (33%) dhe të dhënat e mëdha (28%). Lajmi i mirë është që agjencitë profesionale të mbledhjes tashmë kanë investuar dhe po investojnë ende në takimin dhe përgjigjen ndaj të gjitha këtyre sfidave.


Në lidhje me "Praktikat Evropiane të Pagesave" të Studimit EOS 2018.

Në lidhje me institutin e hulumtimit të pavarur të tregut Kantar TNS (ish TNS Infratest), EOS zhvilloi një intervistë telefonike në pranverë 2018 me 3.400 kompani në 17 shtete evropiane rreth praktikave të pagesave në vendet e tyre përkatëse. 200 kompani me një qarkullim vjetor prej më shumë se 5 milion euro në secilin nga vendet Danimarkë, Gjermani, Mbretëria e Bashkuar, Spanjë, Francë, Belgjikë, Zvicër, Rumania, Republika Çeke, Kroaci, Hungari, Bullgari, Sllovakia, Slloveni, Poloni, Rusi dhe Greqi u përgjigjën pyetjeve në lidhje me përvojat e tyre të pagesave, zhvillimet ekonomike në vendet e tyre dhe çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e riskut dhe menaxhimin e arkëtimit. Anketa u krye për vitin e 11-të në radhë. Për më shumë rezultate nga anketa, ju lutem vizitoni: <https://de.eos-solutions.com/surveys>

Grupi EOS

Grupi EOS është një nga ofruesit kryesor ndërkombëtarë të shërbimeve financiare të personalizuara. Si specialist në vlerësimin dhe përpunimin e arkëtimit, EOS përdor teknologjitë e reja për t'i ofruar 20 mijë klientëve të saj në 26 vende sigurinë financiare nëpërmjet shërbimeve të zgjuara. Biznesi kryesor i kompanisë është blerja e portofolieve të borxheve të pasigurta dhe të sigurta. Duke punuar në një rrjet ndërkombëtar të kompanive partnere, Grupi EOS ka një fuqi punëtore prej rreth 7.500 dhe më shumë se 60 ndihmëse, kështu që mund të ketë burime në më shumë se 180 vende. Sektorët kryesorë të saj janë bankat, shërbimet, pasuritë e patundshme dhe tregti.

Për më shumë informata ju lutemi vizitoni: www.eos-solutions.com




BERSANT DISHA,
DREJTOR EKZEKUTIV, RECURA FINANCIALS

Roli i institucioneve financiare në rritjen e sektorit privat dhe zhvillimin e bujqësisë

Kosova ndër vite ka vazhduar të zhvillohet pozitivisht si në aspektin politik dhe sundimin e ligjit ashtu dhe në atë ekonomik. Ajo ka ruajtur stabilitetin politik dhe ekonomik dhe ka regjistruar norma vjetore të rritjes ekonomike në vazhdimësi prej rreth 3-4% gjatë dekadës së fundit. Megjithatë, ekonomia vazhdon të vuaj nga një deficit i madh i bilancit tregtar, ku eksportet arrijnë vetëm 12.6% të importeve. Kjo konsiderohet si problem kryesorë. Megjithatë, kjo mund të shihet

gjithashtu si një mundësi, veçanërisht në pikëpamjen e rritjes së prodhimit dhe shërbimeve vendore nëpërmjet zëvendësimit të importit, posaçërisht në bujqësi. Institucionet financiare në Kosovë ndër vite kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e rritjes së sektorit privat. Kreditimi është rritur vazhdimisht, pavarësisht nga fakti që institucionet financiare në të kaluarën kanë qenë shumë konservatore dhe me një aversion ndaj rrezikut në vendimet e tyre të huadhënies. Gjithsej kreditë e

lëshuara nga sistemi bankar në fund të vitit 2017 ishin 2.49 miliardë euro, nga të cilat 64% për bizneset, duke përfaqësuar një rritje prej 10.7% krahasuar me një vit më parë. Ky është një trend inkurajues, pasi që rritja nga viti në vit ka qenë graduale, duke shënuar rritje nga 8.3% sa ishte në vitin 2016. Ajo që është interesante të theksohet është se pas rënies së kredive të reja të lëshuara në vitin 2016, rritja e kredive të reja të lëshuara për bizneset ishte 30% në vitin 2017. Kjo rritje kryesisht është nxitur nga kreditë



për investime, duke përbërë më shumë se 50% të kredive të reja të lëshuara. Kjo tregon performancën pozitive të biznesit dhe një besim afatgjatë të sektorit bankar në potencialin e sektorit privat.

Megjithatë, raporti i kreditimit bankar ndaj PBB-së prej vetëm 41.4% tregon se sektori financiar në Kosovë është ende në zhvillim dhe është një tregues i niveleve të ulëta të kreditimit, madje edhe kur krahasohet me mesataren e Ballkanit Perëndimor prej 55%. Përveç kësaj, rezervat bankare tregojnë një sistem mbi-likuid që tregon potencialin për rritje të mëtejshme të aktivitetit kreditues, një konkluzion i konfirmuar edhe nga raportet e Bankës Qendrore. Edhe pse kreditë për biznese përbëjnë pjesën më të madhe të portofolit të gjithsej kredive, hendeku i kreditimit ndaj PBB-së tregon se kreditimi mund të rritet për 50% në mënyrë që të përafrohet me rajonin. Kostoja e huamarrjes ka shënuar rënie, ku normat mesatare të interesit për bizneset janë ulur në 6.5% si mesatare, ndërkohë që në sektorët e perceptuar me rrezik të lartë si bujqësia, janë rreth 7.2%. Struktura e kthimit të kredive për biznese është përmirësuar gjithashtu, me maturitetet e kredive që janë rritur gradualisht, ku shumica janë me maturitet prej 3 vite. Ajo që është interesante megjithatë është pjesa e kredive afatgjata përtej 5 viteve, që përfaqësojnë mbi 30% të gjithsej kredive të lëshuara. Nëse shikojmë në zbrërthim kreditimin e bizneseve nga bankat, shu-


KOSTOJA E HUAMARRJES KA SHËNUAR RËNIE, KU NORMAT MESATARE TË INTERESIT PËR BIZNESET JANË ULUR NË 6.5% SI MESATARE, NDËRKOHË QË NË SEKTORËT E PERCEPTUAR ME RREZIK TË LARTË SI BUJQËSIA, JANË RRETH

7.2%

mica e kredive u janë lëshuar kompanive tregtare, duke përbërë rreth 50% të gjithsej kredive. Më pastaj vijon kreditimi i sektorëve të prodhimit, ndërtimit dhe shërbimeve. Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për sektorin e bujqësisë, edhe pse përbëjnë rreth 10% të PBB-së së Kosovës, ky sektor përfaqëson vetëm 3.4% të kredive për biznese. Edhe pse kreditimi i këtij sektori është rritur në vazhdimësi gjatë viteve të fundit, me një rritje prej 13.4% në vitin 2017, mbetet edhe më tutje pjesë e vogël përbërëse në portofolin e kredive me vetëm 3.5 - 4.5% e që lë shumë hapësirë për përmirësim. Sipas Raportit të Stabilitetit Financiar të BQK-së, rritja e aktivitetit kreditues në bujqësi mund t'i atribuohet kryesisht efektit të garancive të kredive të lëshuara nga Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive, i cili po ndjek skema të ngjashme të garancisë që janë përdorë në të kaluarën siç janë garancitë e USAID DCA për bujqësinë.

Këto të dhëna tregojnë se ka hapësirë të konsiderueshme për zgjerim fitimprurës në kreditë komerciale në sektorin e bujqësisë. Përkundër përsheptimit të kreditimit për sektorin e bujqësisë, ai mbetet afërsisht i njëjtë në proporcion me portofolin e përgjithshëm të kreditimit, duke variuar historikisht ndërmjet 3.2% dhe 4.5%. Kjo përfaqëson më pak se gjysmën e kontributit të bujqësisë në PBB.

Hendeku në financimin nga bankat për sektorin e bujqësisë mbulohet pjesërisht nga huadhëniet e institucioneve mikro-fi-



Agricultural loans as percentage of overall loan portfolio Banks and Microfinance institution versus agriculture contribution GDP.
Source: Central Bank of Kosovo, Kosovo Statistic Agency

nanciare, duke përfaqësuar rreth 24% të gjithsejt kreditimit të bujqësisë nga sektori financiar për vitin 2017. Megjithatë, shumat mesatare të ulëta të kredive të IMF-ve të shoqëruara me maturitete më të shkurtëra si dhe baza kryesisht jo-formale e klientëve, paraqet një faktor shumë kufizues për financimin nga IMF-të për rritje dhe konsolidim të sektorit. Nga portofoli i përgjithshëm i kredive të IMF-ve, prej 143.9 milionë eurosh, 46% e huadhënies është për bizneset duke shënuar rritje vjetore prej 44.1% në vitin 2017, ku bujqësia përfaqëson 26.6% të këtij portofoli. Aversioni ndaj riskut i perceptuar nga Bankat për financimin e agrobizneseve, dhe mbi-likuiditeti i lartë dhe shfrytëzimi i ulët i kapaciteteve kredituese, nuk mund të shpjegohet vetëm sipas rrezikut në tregun bujqësor.

Pavarësisht nga rreziqet e perceptuara të tregut, si dhe nga problemet e raportuara me përmbarimin e kontratave dhe sigurisë nga bankat, raporti i Kredive Jo-Performuese ka vazhduar të jetë më i ulët në rajon dhe ndër më të ulët në Evropë, aktualisht në gjithsejt 3.1% dhe vetëm 4.1% për kredite për bizneset në vitin 2017, duke shënuar kështu nivelin më të ulët të KJP në të gjithë rajonin (mesatarja rajonale në mbi 10%).

NGA PORTOFOLI I PËRGJITHSHËM I KREDIVE TË IMF-VE PREJ

€143.9 milion,

46%

E HUADHËNIES ËSHTË PËR BIZNESET QË SHËNOJNË RRIJTJE VJETORE PREJ

44.1%

NË VITIN 2017, KU BUJQËSIA PËRFAQËSON 26.6%

26.6%
TË KËTJË PORTOFOLI.

Madje edhe sektori i bujqësisë i cili ka normën më të lartë të KJP-ve prej 8.2% për kredite bankare ende është nën KJP-në e përgjithshme rajonale. Kreditë më të vogla të lëshuara nga IMF-të kanë një përqindje edhe më të ulët të KJP-ve, me një mesatare prej 2.7%. Përvoja e IMF-ve, me një KJP shumë më të ulët dhe një ekspozim shumë më të lartë proporcional në sektorin e bujqësisë, përfshirë edhe ndaj fermerëve individualë, është një tregues i mirë i potencialit për rritjen e financimit për këtë sektor nga ana e Bankave gjithashtu.

Bankat ende mbesin shumë konservative në vendimet e tyre kredituese dhe shumë sipërfaqësor në produktet financiare të ofruara. Ka një numër arsyesh pse bankat nuk kanë qenë në gjendje të plasojnë mbi-likuiditetin e tyre në treg. Politikat dhe praktikatat aktuale të menaxhimit të rrezikut të bankave të Kosovës varen shumë nga kolaterali, veçanërisht nga kolaterali i patundshmërië i bazuar në hipotekë. Nëse bankat nuk veprojnë në mënyrë aktive për të ndryshuar këtë qasje, duke adaptuar praktika alternative të matjes dhe menaxhimit të riskut, do të çoj drejt një vazhdimësie të gjendjes së tregut me likuiditet të tepërt dhe financim të mangët për bizneset, në veçanti për



sektorët që nuk i përkasin tregtisë. Për bujqësinë në veçanti, bankat hezitojnë të kreditojnë për arsye të qarkullimit jo të rregullt të parasë, përfshirë këtu periudha të ndryshme kohore të rrjedhës së shpenzimeve dhe të ardhurat jo të rregullta, mungesës së kolateralit të mjaftueshëm të pranueshëm nga bankat dhe risqet e perceptuara të prodhimit që ndërliken me kushtet klimatike, sëmundjet dhe risqet e tregut. Prezantimi i produkteve të reja financiare të kombinuara me praktikë alternative të menaxhimit të rrezikut paraqesin mundësi të reja për konsiderim. Kjo mund të përfshijë ofrimin e maturiteteve më të gjata të kredisë, veçanërisht për agrobizneset, duke marrë parasysh natyrën më afatgjatë të investimeve dhe strukturat e ndryshme të kthimit të kredisë të përshtatshme për këtë sektor. Praktikë e menaxhimit të rrezikut të kredisë duhet gjithashtu të përshtaten duke u larguar nga kolaterali i bazuar në hipotekë të drejt strukturave më dinamike që marrim parasysh historikun kreditor të biznesit dhe rrezikun e zinxhirit të vlerave. Korniza ligjore gjithashtu mund të rregullohet për të lejuar shfrytëzimin e llogarive të arkëtueshmeve si garanci. Bankat dhe IMF-të gjithashtu mund të përmirësojnë menaxhimin e riskut duke përmirësuar monitorimin e pas

kreditimit të performancës së sektorit dhe klientit dhe duke shfrytëzuar këtë qasje aktive në menaxhimin e rrezikut dhe gjenerimin e kredive të reja potenciale. Bankat gjithashtu mund të marrin për konsideratë serioze futjen e produkteve të reja financiare si financimi i bazuar në kontratë, i cili synon financimin e prodhuesve / furnizuesve që kanë një marrëdhënie formale dhe të vazhdueshme me blerësit e tyre brenda një zinxhiri vlerash, kështu që banka krediton një huamarrës duke u bazuar në kontratën e furnizimit me një blerës, duke kolateralizuar llogaritë e të arkëtueshmeve që lidhen me transaksionin dhe kështu duke hequr kufizimet në kreditim që lidhen me kolateral të pamjaftueshëm, dhe duke aplikuar procesin e transferimit të një pjese të rrezikut të kredisë tek palët e tjera. Bankat duhet të konsiderojnë sektorët e prodhimit, të shërbimeve si dhe bujqësinë si potencialin kryesor të rritjes për aktivitetet e tyre të huadhënies për bizneset. Në veçanti, mundësitë qëndrojnë në produktet dhe shërbimet e zëvendësimit të importit, si dhe në disa sektorë potencialë për rritjen e eksporteve. Përmirësimi i qasjes në financa do të përmirësonte konkurrencën e agrobiznesit si në tregun vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar, duke rritur kështu

mundësitë e kreditimit. Institucionet financiare duhet të shqyrtojnë gjithashtu shfrytëzimin e politikave kombëtare për bujqësinë në Kosovë, duke shfrytëzuar mundësi që ofrohen përmes subvencioneve dhe granteve të ofruara për këtë sektor (100 milion € gjatë 2013 -2016). Në kushtet e një kostoje të ulët të financimit për institucionet financiare, veçanërisht për bankat depozitmarrëse, investimi në rritjen e aktiviteteve të kreditimit është alternativa më fitimprurëse për përdorimin e fondeve. Kjo e shoqëruar me likuiditetin e lartë të sektorit ofron një mundësi për bankat që të rrisin kreditimin. Ulja e pragut të kërkesave të bazuar në asete dhe të kombinuar me qasjet dhe praktikë e menaxhimit të rrezikut alternativ si dhe produktet e reja të kredive do të siguronin rritjen e suksesit si për institucionet financiare ashtu edhe për agrobizneset. Nëse kreditimi i bujqësisë do të ishte një pasqyrë mbi kontributin e sektorit drejt PBB-së, kjo do të nënkuptonte se 80 milion euro shtesë do të mund të plasoheshin potencialisht në sektorin e bujqësisë nga institucionet financiare duke ndikuar në gjenerimin e deri në 10,000 vendeve të reja të punës në këtë sektor dhe duke nxitur rritje të mëtutjeshme dhe mundësi për më shumë financim në të ardhmen.

NORMA MESATARE EFEKTIVE E INTERESIT NË KREDI NDËR VITE

2010

13.97%

2014

9.24%

2018

6.99%

KREDITË JOPERFORMUESE

2016

4.9%

2017

4.9%

2018

2.8%

KREDITË PËR BIZNESET DHE PËR EKONOMITË FAMILJARE

Bzinesse

64%

Familjare

36%

Praktikanti nga Deutsche Bank viziton Shoqatën e Bankave të Kosovës



Kishim kënaqësinë të mirëpresim z. Tillmann Jaenke për një vizitë të shkurtër në Shoqatën e Bankave të Kosovës gjatë programit të tij të praktikës që po përfundonte në Bankën Qendrore të Kosovës. Ne konsideruam se ai kishte një përvojë të mrekullueshme për të ndarë me ne në lidhje me programin e tij të praktikës dhe përshtypjet e tij në Kosovë, të cilën ai me kënaqësi kanë ndarë me në artikullin vijues. Ne i urojmë atij më të mirën në karrierën e tij të ardhshme dhe inkurajojmë institucionet e tjera që të ofrojnë mundësi të tilla të mira praktike për bankierët e ri.

PETRIT BALIJA,

DREJTOR EKZEKUTIV, SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

Emri im është Tillmann Jaenke dhe aktualisht jam student dhe punonjës i Deutsche Bundesbank, banka qendrore e Gjermanisë, kam pasur rastin të bëj një praktikë në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) këtë verë, dhe në këtë mënyrë pata rastin ta njoh këtë vend të bukur e interesant dhe popullin. Kjo më mundësoi që të fitoj një perspektivë të re dhe më të gjerë për bankat në përgjithësi, bankën qendrore dhe mbikëqyrjen bankare, në veçanti fushën time personale të punës.

Për tre vitet e fundit, kam marrë pjesë në programin e studimeve të dyfishtë të Deutsche Bundesbank dhe përfundova studimet në Bachelor i Shkencës në Bankën Qendrore në Shtator. Bundesbank ofron një program të integruar, në të cilin studentët ndjekin universitetin, duke performuar periudha praktike, gjatë të cilave ata punojnë në fusha të ndryshme të biznesit të

Bundes-bankës, në mes të semestrave. Studimet teorike zhvillohen në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Bundes-bankës në një qytet të vogël rural në Gjermaninë Perëndimore dhe përbëhen nga kurse të përgjithshme të administrimit të biznesit, siç janë kontabiliteti, financimi i korporatave, matematika financiare, ekonomia ndërkombëtare, ligji dhe IT, si dhe kurset specifike të përshtatura ndaj nevojave të bankës qendrore, përkatësisht mbikëqyrjes bankare dhe letrave me vlerë, politikës monetare, stabilitetit financiar dhe funksionimit të sistemeve të pagesave. Gjatë programit të studimit, këto module teorike ndryshojnë me periudha praktike, në të cilat studentët punojnë në të gjitha fushat kryesore të biznesit të Bundesbank në selinë qendrore në Frankfurt dhe zyrat rajonale në qytete në të gjithë Gjermaninë. Në këto periudha praktike, studentët mund të aplikojnë njohuritë teorike që

kanë fituar në universitet dhe të përgatiten për punën e tyre të mëvonshme në Bundesbank pas Bachelor-it të tyre. Në muajt e fundit të programit studimor, studentët kanë mundësi të shkojnë jashtë vendit dhe të plotësojnë një nga modulet praktike si një periudhë praktike në një institucion financiar publik ose autoritet në Evropë.

Vendosa të bëja praktikën time në Kosovë, sepse u ofrua një mundësi emocionuese për të njohur një mjedis bankar dhe përvoja pune e cila është e vendosur ndryshe nga eksperiencia që kisha nga Gjermania dhe Bundesbank. Kam qëndruar në Kosovë për një total prej gjashtë javësh dhe gjysmë javë në gusht dhe shtator dhe gjatë asaj kohe kam punuar në departamente të ndryshme të BQK-së. Une kam njohur ndarjen inspektuese në vend të departamentit të mbikëqyrjes bankare, departamentin e sistemeve të pagesave, thesarin dhe ndarjen e parave, megjil-

these kam kaluar shumicën e kohës time në një ekip që ka të bëjë me zbatimin e kuadrit të Bazelit në Kosovë. Kjo përshtatur mirë me kurrikulën time në universitet, ku kisha zgjedhur një specializim mbi funksionet e mbikëqyrjes dhe stabilitetit financiar gjatë dy semestrave të fundit. Një nga pikat kryesore të specializimit ishte kuadri rregullator i Bazelit, kështu që unë kam qenë në gjendje të kontribuoj në punën e ekipit. Kjo ishte shumë interesante për mua, sepse unë kam për të aplikuar të njëjtat bazat rregullatore në një mjedis krejtësisht të ndryshëm. Industria financiare gjermane padyshim ndryshon dhe është shumë më komplekse sesa sektori relativisht i ri bankar i Kosovës, dhe ishte freskuese për të punuar në një kontekst rregullator të drejtpërdrejtë, pa veçantitë, përjashtimet dhe të gjitha llojet e karakteristikave individuale që janë rritur me kalimin e kohës dhe e bëjnë navigimin e mjedisit rregullator gjerman aq sfidues. Gjatë praktikës, kam pasur rastin të vizitoj zyrat e Shoqatës Bankare të Kosovës dhe të mësoj për punën që bën kjo organizatë, e cila ishte një eksperiencë shumë interesante. Unë kam qenë i intriguar për të marrë një vështrim në thellësi në sektorin bankar të një vendi tjetër, pasi që më parë kisha përvojë vetëm në atë gjerman. Sektorin bankar i Gjermanisë përbëhet nga tri shtylla, të cilat janë krijuar gjatë shekujve: banka rajonale e kursimeve publike të pronësuara nga qytetet ose shtetet, bankat rajonale bashkëpunuese të themeluara fillimisht nga popullata lokale dhe sigurisht bankat e rregullta private, të gjitha së bashku arrinë në rreth 1.800 banka. Prandaj, u intrigova që Kosova, duke qenë një vend shumë i ri, ka një sektor bankar shumë të përqendruar prej vetëm 10 bankave,



VENDOSA TË BËJA PRAKTIKËN TIME NË KOSOVË, SEPSE U OFRUA NJË MUNDËSI EMOCIONUESE PËR TË NJOHUR NJË MJEDIS BANKAR DHE DHE PËRVOJË PUNE E CILA ËSHTË NDRYSHE NGA EKSPERIENCA QË KISHA NGA GJERMANIA DHE BUNDESBANK.




TILLMANN JAEENKE

ku shumica e tyre janë të huaja. Bankat e Kosovës janë gjithashtu shumë të centralizuara në strukturë, në krahasim me bankat rajonale që mbizotërojnë tregun gjerman të konsumit. Ky ishte një mjedis shumë i ndryshëm për mua që të punoja, dhe sigurisht që ka përfitime në krahasim me sektorin bankar të fragmentuar gjerman, i cili ka problem në çështjet e trashëgimisë që datojnë një kohë të gjatë më parë. Meqenëse Kosova po ndryshon dhe zhvillohet kaq shpejt, sektori bankar ndoshta do të ndryshojë shumë, dhe unë jam i interesuar se si do të duket në 20 vite. Në fund të praktikës sime, morra pjesë në një seminar rajonal të bankave qendrore të Ballkanit Perëndimor në Prevallë në rajonin e bukur malor të Sharrit. Unë kisha marrë pjesë në përgatitjet për punëtorinë dhe kjo ishte një mundësi e shkëlqyeshme për mbikëqyrësit bankarë dhe përfaqësuesit e industrisë bankare të Kosovës që të krijojnë kontakte dhe të ndajnë përvojat me kolegët e tyre nga rajoni, si dhe përfaqësues nga Bundesbank, BaFin (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Gjermane) dhe institucionet evropiane.

Që kur jam kthyer në Gjermani në Shtator, kam mbaruar studimet Bachelor dhe kam filluar në pozitën time të parë në Bundesbank. Tani po punoj në mbikëqyrjen bankare si një inspektor në vend që përqendrohet në rrezikun e tregut. Me të vërtetë e kam gëzuar qëndrimin tim në Kosovë dhe dëshiroj të mendoj përsëri kohën që kam kaluar atje, që patjetër i tejkalova pritjet e mia. Njerëzit janë shumë të gatshëm dhe miqësorë, natyra është e bukur dhe vendi ka shumë për të ofruar. Në përgjithësi, jam shumë mirënjohës që kam pasur rastin të vizitoj këtë vend interesant, të bëj miq të rinj dhe të zgjeroj horizontin tim.

Organizuar nga:



Përkrahur nga:



Dita Botërore e Kursimeve

KURSE MJEDISIN,
KURSE SHKOLLEN,
KURSE PARANË!

Shoqata e Bankave të Kosovës shënon Ditën Botërore të Kursimeve

Duke u bashkëngjitur në aktivitetin mbarëbotërorë, Shoqata e Bankave të Kosovës përmes aktiviteteve të saja edukativo-arsimore me fëmijë shënoi Ditën Botërore të Kursimeve. Me moton “vepro mençur, kurse sot”, Shoqata e Bankave të Kosovës bëri hapjen e Ditës Botërore të Kursimeve në shkollën fillore “Qamil Batalli” në Prishtinë.

Në fjalimin e tij hyrës drejtori i shkollës Liridon Maliqi iu drejtua nxënësve duke i inkurajuar ata që të kursejnë.

Ndërsa në fjalimin e tij drejtori i Shoqatës së Bankave të Kosovës Petrit Balija theksoi rëndësinë që edukimi financiar ka për krijimin e mirëqenies për të gjithë shoqërinë.

Balija inkurajoi fëmijët që të fillojnë të kursejnë dhe jo vetëm paratë, por edhe mjedisin, paisjet e shkollës etj.

Dita e Kursimeve ka filluar të shënohet shumë vite më parë në Milano, dhe kishte për qëllim që rritë vetëdijën e popullatës rreth rëndësisë së kursimit dhe menaxhimit të parasë.

Edukimi financiar është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të gjithë, pavarësisht moshës, ndërsa të marrësh një edukim financiar qysh nga mosha e re është një përparësi e madhe.

Duke pasur parasysh rëndësinë e edukimit financiar Shoqata e Bankave

të Kosovës në kuadër të aktiviteteve të saj për përgjegjësi shoqërore organizon aktivitete të tilla me qëllim që të krijohet kultura e kursimit e resurseve të cilat i kemi në dispozicion. Qëllimi kryesor është fuqizimi i gjeneratave të reja, që të marrin njohuri ekonomike-financiare nga ekspertë të sistemit bankar dhe rrjedhimisht të jenë të përgjegjshëm me financat e tyre, duke arritur të kursejnë për planet e tyre në të ardhmen.

Roli i sektorit bankar për të ndihmuar në edukimin financiar të gjeneratave të reja është jashtëzakonisht i rëndësishëm duke kontribuar kështu edhe në krijimin e një shoqërie e cila ka njohuri të mira për parane, menaxhimin e parasë dhe financave personale.

Përveç ligjeratës në shkollen fillore “Qamil Batalli”, Shoqata e Bankave të Kosovës do të bëjë shpërndarjen e librit për Edukim Financiar dhe material shkollor për nxënësit e shkollës fillore “Dituria” në Shkabaj si dhe nxënësit e organizatës “The Ideas Partnership” në Fushë Kosovë.

Ky aktivitet është organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës me përkrahjen e bankave anëtare: Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare, Banka për Biznes, IsBank, NLB Prishtina, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank, TEB Bank dhe Ziraat Bank.



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS ORGANIZON TRAJNIMIN “MENAXHIMI I RESURSEVE NJERËZORE PËR UDHËHEQËSIT E EKIBEVE”

Në kuadër të trajnimeve të Shoqatës së Bankave të Kosovës është organizuar trajnimi “Menaxhimi i resurseve njerëzore për udhëheqësit e ekipeve” me 6-9 nëntor 2018. Trajnimi është ligjeruar nga Z.Gilles Ossoona de Mandez nga organizata partnere House of Training/ATTF nga Luksemburgu.



Reforma e Rregullativës Bankare dhe sfidat e së ardhmës

Shoqata e Bankave të Kosovës ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga BQK dhe GIZ dhe e mirepritur nga Qenda e Trajnimeve Regjionale të Pro Credit Bank në Prishtinë. Kjo punëtori shënon përfundimin e Projektit të Zbatimit të Bazelit i cili u mbështet nga GIZ dhe u zbatua gjatë tre viteve të fundit në Kosovë. Në fjalën hyrëse të hapjes, kryetari i bor-

dit të SHBK-së z. Ilir Aliu, në emër të sektorit bankar, falënderoi BQK-në dhe GIZ-in për organizimin e punëtorisë dhe pjesëmarrësve nga institucionet e BE-së dhe rajonit.

Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal si dhe me institucionet e BE-së në zbatimin e standardeve të Bazelit duke thënë:

“Për ne ky është një tjetër hap përpara në rritjen e perspektivës rregullatore, si dhe në përafrimin e standardeve të mbikëqyrjes së sektorit bankar me standardet e BE-së.

Z. Aliu gjithashtu theksoi se të gjitha bankat po bëjnë përparim të nevojshëm drejt përgatitjes së plotë për hapat përfundimtarë në këtë proces; si BQK-ja dhe SHBK po u japin ndihmë



Shoqata e Bankave të Kosovës organizoi sesion informues me temë Menaxhimi i Sigurisë Kibernetike dhe të Informacionit

Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me House of Training nga Luxemburgu organizuan sot sesionin informues gjysmë-ditor me temën “Menaxhimi i Sigurisë Kibernetike dhe Informacionit”. Ky sesion informues mbledhi të gjithë akterët relevant nga sektori financiar si dhe nga organet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e ligjit. Në fjalimin e tij hyrës, drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës Petrit Balija theksoi rëndësinë e Sigurisë Kibernetike dhe të Informacionit në kuadër të zhvillimeve të reja në shërbimet digjitale bankare. Tutje, ai përmendi një ndër



Shoqata e Bankave të Kosovës organizon trajnimin për FATCA

bankave për të ndërtuar kapacitete në bankat e Kosovës. Folës të tjerë përfaqësinin Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, (BQK) Z. Fehmi Mehmeti, GIZ Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit GmbH Country Director Kosovo Z. David Oberhuber, Deutsche Bundesbank Head of Technical Assistance Z. Martin Dinkelborg, përfaqësues i FMN- së, etj.

Në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës me datë 25 tetor 2018 është organizuar trajnimi mbi “Aktin e pajtueshmërisë tatimore të llogarive të jashtme/Foreign Account Tax Compliance Act” e cila në fakt është një marrëveshje në mes të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara Amerikane dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila obligon institucionet financiare të raportojnë përmes Administratës Tati-

more të Kosovës për llogaritë financiare të shtetasve amerikan tek Shërbimi i të Hyrave të Brendshme të ShBA-së. Trajnimi është ligjërues nga z. Nigel R. Douglas i cili ka përvojë të madhe në fushën e zbatueshmërisë së FATCA-së në banka të njohura ndërkombëtare.

Pjesëmarrës në trajnim kanë qenë punonjës të bankave nga Kosova dhe Shqipëria si dhe përfaqësues nga Administrata Tatimore e Kosovës.

faktorët më me rëndësi në avansimin e shërbimeve bankare dhe raporteve bankë-klient siç është besimi në sigurinë e shërbimeve bankare në veçanti atyre elektronike. Gjithsesi, industria bankare në Kosovë është duke bërë investime të vazhdueshme në siguri por edhe në ngritjen e kapaciteteve njerëzore në lidhje me sigurinë kibernetike dhe të informacionit dhe kjo është evidente edhe nga trajnimet dhe sesionet e organizuara nga Shoqata e Bankave të Kosovës në partneritet me institucionet ndërkombëtare me përvojë të gjerë në këtë fushë siç është House of Training

nga Luxemburgu. Qëllimi ynë si sektor bankar është që të iu ofrojmë klientëve bankar një shërbim sa më të lehtë dhe të sigurtë në mënyrë që ata t'i realizojnë qëllimet e tyre me ndihmën e bankës, por për të arritur më shumë progres në këtë drejtim na duhet të koordinojmë dhe bashkëveprojmë me institucionet relevante siç është Policia e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës dhe institucionet tjera relevante. Ligjeruesi prezantoi materiale informuese për të pranishmit nga perspektiva globale e kësaj çështje e cila është duke marrë vëmendje të madhe nga sistemet finan-

ciare edhe në vendet e zhvilluar por në veçanti në ato në zhvillim si Kosova. Në pjesën e diskutimit pjesëmarrësit parashtruan pyetje konkrete tek ligjeruesi Hristiyan Lazarov si dhe zhvilluan një diskutim të gjerë rreth kësaj fushe. Përveç mundësisë për diskutim rreth kësaj teme mjaft të rëndësishme në bankimin e ditëve të sotme, gjithashtu pjesëmarrësit patën mundësinë për rrjetëzim dhe shkëmbim të ideve rreth temes. Një përkrahje e rëndësishme për këtë event u ofrua edhe nga kompania Asseco.

“Banka Ekonomike në mbështetje të sportit”

Bizneset në mbarë botën çdo ditë e më shumë kujdesen që përveç suksesit në fushën ku operojnë, të kontribuojnë edhe në mirëqenien e të gjitha palëve të interesit, e cila sot nënkupton gjithë ambientin socio-ekonomik që i rrethon. Banka Ekonomike e merr këtë obligim me përgjegjësi të lartë dhe angazhohet me përkushtim të japë kontributin e saj në këtë aspekt. Prandaj, mbështetja e vazhdueshme e aktiviteteve sociale, kulturore dhe arsimo re mbetet qëllim i rëndësishëm në përmbushjen e misionit

të bankës. Banka Ekonomike ka ndërtuar një traditë të gjatë të bashkëpunimit me institucione vendore të cilat kanë për qëllim përmirësimin e ambientit social. Një ndër qëllimet parësore është mbështetja konkrete dhe e menjëhershme në zgjidhjen e problemeve aktuale shoqërore. Kështu, Banka Ekonomike sikurse edhe në vitet paraprake ka vazhduar mbështetjen duke përkrahur sportistët dhe klubet tona në përmirësimin e kushteve infrastrukturore, pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare etj. Banka ka



mbështetur klubin e futbollit të femrave KFF Hajvalia, klubin e hendbollit KH Vllaznimi nga Gjakova, si dhe klubin e futsallit FC Prishtina. Krahas ofrimit të mbështetjes për klubet sportive, Banka Ekonomike poashtu ka mbështetur edhe organizimin e Turneut të Bamirësisë të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane.

Raiffeisen Banka përkrah projektin kulturor për fëmijët me sindromën Down

Fëmijët me sindromën Down duhet të trajtohen si të gjithë fëmijët tjerë prandaj edhe projekti në fjalë ka për qëllim ndërgjegjësimin e shoqërisë për fëmijët me sindromën Down. Përmes projektit do të bëhet sensibilizimi i opinionit duke stimuluar/inkurajuar përmes aktiviteteve muzikore fëmijët me sindromën Down së bashku me moshatarët e tyre. Këta fëmijë do të performojnë tek audiencia aftësitë,



talentin, shmangien e izolimit si dhe përafrimin në realizimin e ëndrrave të tyre për mundësi të barabarta dhe integrim brenda shoqërisë në fushën e muzikës dhe kulturës. Banka Raiffeisen është sponsor i këtij projekti dhe ky projekt do të zgjasë për 6 muaj deri në fund të muajit janar 2019. Qëllimi i projektit është të organizoj programe me karakter tradicional për fëmijët me sindromën Down.



Gjaku yt shpëton jetë

Banka Kombëtare Tregtare SH.A në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të gjakut, organizoi përsëri ditën e dhurimit vullnetar të gjakut. Gjatë ditës u mbledhën 43 qese me gjak, veprim ky që tregon kontributin e vërtetë të bërë nga punonjësit e Bankës. Banka Kombëtare Tregtare SH.A shpreson se ky dhurim i gjakut do të ndihmojë në motivimin dhe rritjen e frymës dhe vetëdijes së njerëzve për rëndësinë e dhurimit të gjakut dhe vullnetit për të ndihmuar njëri-tjetrin. Aktiviteti i dhurimit të gjakut i organizuar nga BKT pati sukses. Kjo është e dukshme nga entuziazmi i treguar nga punonjësit e Bankës që mbështetën plotësisht aktivitetin. Numri i dhuruesve të gjakut do të rritet padyshim në të ardhmen, marrë për bazë se ky aktivitet është vendosur në kalendarin e aktiviteteve të zakonshme të Bankës Kombëtare Tregtare SH.A.

NLB Banka mbështet fushatën “Ti je një luledielli”

Nga dëshira dhe vullneti për të ndihmuar fëmijët dhe për të përmirësuar kushtet në të cilat ata kurohen dhe trajtohen, NLB Banka ka mbështetur fushatën “Ti je një luledielli”, duke blerë 500 bluza për të gjithë të punësuarit e saj. Kjo fushatë ka për synim t’u dalë në ndihmë fëmijëve të prekur nga sëmundjet e gjakut, leukemi dhe kancer. Paratë, të cilat shkojnë 100% donacion, do të përdoren për të blerë pajisjen në repartin e onkohematolo-



gjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Kontributi i NLB Bankës do të vazhdojë edhe në të ardhmen në mbështetje të aktiviteteve dhe projekteve të rëndësishme humanitare, sociale, kulturore e ekonomike.

PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS


“The Kosovo Banker” është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit dhe ka për qëllim të informojë publikun lidhur me industrinë bankare në Republikën e Kosovës. Për më tepër informata, drejtohuni tek web faqja e Shoqatës së Bankave të Kosovës



www.bankassoc-kos.com

Edicionet e The Kosovo Banker:





QENDRA E TRAJNIMEVE NË SHOQATEN E BANKAVE TË KOSOVES

Ofron trajnime të ndryshme për sektorin financiar të Kosovës duke përfshirë edhe këto fusha:

- > Menaxhimi rrezikut bankar
- > Pajtueshmëri dhe Parandalimin e Pastrimit të Parave
- > Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
- > Auditim dhe kontroll i brendshëm
- > Menaxhimi i Aseteve dhe Detyrimeve
- > Bankingu Digjital
- > Menaxhimi i sigurisë kibernetike dhe i informacionit
- > Vlerësimi i kreditë
- > Shitja e shërbimeve financiare
- > Financimi i tregtisë
- > Mbrojtja e të dhënave personale
- > Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- > Udhëheqje dhe menaxhim

PARTNERËT:



Qendra për trajnime bankare në kuadër programit të saj të trajnimeve ofron edhe certifikime të njohura ndërkombëtare, uebinare dhe trajnime përmes kanaleve elektronike në fushën e industrisë bankare.

REDUKTIMI I TRANSAKSIONEVE ME PARA TË GATSHME

A E KENI DITUR SE PËRDORIMI I KARTELËS BANKARE
SJELLË SHUMË BENEFITE



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

038 246 171
www.bankassoc-kos.com